

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Libri i Charles Spencer zbulon përplasjen me mbretin Charles pas vdekjes së Lady D: Do ta harrojmë sh pejt Dianën
ADRESA	https://piranjat.al/bota/libri-i-charles-spencer-zbulon-perplasjen-me-mbretin-charles-pa-s-s-se-i104591
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 07:30:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 07:17:13 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	465f6cdbf9b55a8f588caec3f2fdffc4026ca691ec3452973bc0ce2f18159ae6
TEKSTI	6ba44d5737e85c7b67861c7dcb006f3e1f85fa807b31b3d5ef7dc42603a4651e
PAMJA	40398c55ea0c249b189654476e8ff2464b73df60c4d6e17932392762c2979d73

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	24a689d41f3b8e098f5130a816c71a544e8a3cb54b92a24e22b439f82696c148
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	81c8c13b2047f7f67d44b50c2b734087e798480a3f28f7a7cb4e41f88dd32922
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/24a689d41f3b8e098f5130a816c71a544e8a3cb54b92a24e22b439f82696c148

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



BOTA

Libri i Charles Spencer zbulon përplasjen me mbretin Charles pas vdekjes së Lady D: Do ta harrojmë shpejt Dianën

Piranjat Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 09:17



Familja mbretërore britanike pritet të përballet me zbulime të reja mbi periudhën pas vdekjes së Princeshës Diana, përmes librit të vëllait të saj, Charles Spencer, "Swan Swan: Diana, Motra Ime".

Në libër, Konti Spencer rrëfen detaje të panjohura rreth marrëdhënies së tij me mbretin Charles, atëherë Princ i Uellsit, si dhe një përplasje mes tyre për mënyrën se si do të zhvillohej funerali i Dianës.

Sipas Spencer, ai i kundërshtoi idenë që dy djemtë e Dianës, William dhe Harry, përkatësisht 15 dhe 12 vjeç në atë kohë, të ecnin pas arkivolit të nënës së tyre gjatë procesionit mortor. Ai argumentonte se Diana nuk do të dëshironte që fëmijët e saj t'i nënshtroheshin një prove të tillë publike.

Megjithatë, sipas rrëfimit të tij, Princi Charles këmbënguli që djemtë të merrnin pjesë në procesion, duke iu referuar edhe faktit se ai vetë kishte ecur pas arkivolit të xhaxhait të tij, Lord Mountbatten, në vitin 1979.

Spencer tregon se gjatë një telefonate, ai i kujtoi Charlesit se në atë kohë kishte qenë 30 vjeç dhe se situata nuk mund të krahasohej me atë të dy djemve të Dianës.

Sipas librit, pas një përplasjeje të tensionuar, Charles i tha Spencerit: "Ji i sigurt, do ta harrojmë së shpejti".

Deklarata, sipas Spencer, e tronditi. "Nuk mund ta besoj që sapo e the këtë", i është përgjigjur ai, përpara se të mbyllte telefonin.

Konti Spencer pretendon se komentet e Charles pasqyronin "përbuzjen e tij të shtypur për Dianën" dhe shqetësimin e tij për reagimin e jashtëzakonshëm të publikut pas vdekjes së saj.

Ai thotë se vendosi të shkruante "Swan Swan: Diana, Motra Ime" për të korrigjuar ato që i konsideron "pasaktësi" të thëna ndër vite për motrën e tij.

Diana humbi jetën më 31 gusht 1997 në një aksident automobilistik në Paris. Gjashtë ditë më vonë, më 6 shtator, u zhvillua funerali i saj në Westminster Abbey, ndërsa Charles Spencer mbajti fjalimin e famshëm kushtuar motrës së tij.

Gjatë procesionit në Londrën qendrore, Spencer eci pas arkivolit së bashku me William, Harry, Charles dhe Philip. Ceremonia u ndoq në mbarë botën dhe u transmetua për një audiencë të vlerësuar në rreth 2.5 miliardë njerëz.

Artikuj te sugjeruar

Piranjat News BOTA 17 Shtator08:11

[**VIDEO/ Vrasësi serial arrestohet i maskuar si grua në Brazil: Kam vrarë 80 persona**](#)

Një burrë 33-vjeçar i dyshuar për një seri vrasjesh, i cili thuhet se ka rrëfyer vrasjen e rreth 80 personave gjatë jetës...

BOTA 16 Shtator23:28

[**“NATO po përballlet me mjedisin më të rrezikshëm të sigurisë”, Rutte thirrje Evropës**](#)

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka paralajmëruar se Aleanca përballlet me një situatë gjithnjë e më të...

BOTA 16 Shtator22:45

[**VIDEO- Dy aksidente me pesë viktimë/ Prezantuesja e përlotur ishte live kur ndodhi tragjedia e kolegëve të saj**](#)

Pesë persona kanë humbur jetën në një aksident të dyfishtë tragjik në Los Anxhelos, ndërsa një gazetare televi...

BOTA 16 Shtator21:41

[**VIDEO/ Momenti kur polici godet brutalisht gruan e prangosur dhe e përplas në furgon**](#)

Ky është momenti tronditës kur një efektiv policie i jep një goditje të fortë në fytyrë një gruaje të pra...

BOTA 16 Shtator21:20

[**21 viktimë nga shembja e një ndërtese në Gaza, mes tyre tetë fëmijë**](#)

Të paktën 21 persona, mes tyre tetë fëmijë, kanë humbur jetën pasi një ndërtesë e dëmtuar nga lufta u she...

BOTA 16 Shtator21:14

[**Takim sekret për Iranin/ Krerët ushtarakë të SHBA, Izraelit dhe 7 vendeve arabe u mbledhën në Gjermani**](#)

Komandantët e lartë ushtarakë të SHBA-ve, Izraelit dhe disa vendeve arabe janë takuar javën e kaluar në Gjermani për t&e...

BOTA 16 Shtator19:57

[**VIDEO e tmerrshme/ I varuri nga droga rrihet barbarisht deri në vdekje për 20 euro**](#)

Tronditje në Spanjë, pas vdekjes së një burri të pastrehë në Granada, i cili ndërroi jetë nga plagët e marra p...

BOTA 16 Shtator19:04

[**Të dhënat e qindra klientëve të evropianë të një banke dixhitale bien në duart e hakerëve**](#)

Të dhënat personale të qindra klientëve evropianë të bankës dixhitale Revolut janë marrë nga hakerë, të c...

BOTA 16 Shtator18:59

[**E veja e biznesmenit të pasur padit burrin eskortë për 10 milionë dollarë**](#)

E veja e pasur e një prej shpikësve të “Roblox”-it pretendon se është mashtruar për një shumë marramendë...

BOTA 16 Shtator18:46

[**Britania: Mbështesim fuqishëm Kosovën, jemi krenarë për ndërhyrjen e NATO-s më 1999**](#)

Mbrëtëria e Bashkuar e mbështet fuqishëm shtetin e Kosovës dhe ndihet krenare që me aleatët e NATO-s intervenoi më 1999, ka d...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

[**Sarandë, tre persona plagosen me thikë pranë sh...**](#)

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në Sarandë, ku tre persona kanë mbetur të plagosur me ...

BOTA 16 Shtator

[**VIDEO- Dy aksidente me pesë viktimë/ Prezantues...**](#)

Pesë persona kanë humbur jetën në një aksident të dyfishtë tragjik në Los Anxhelos, ndërsa një gazetare televi...

KOSOVA 16 Shtator

Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me...

Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjykues në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

INVESTIGIME 31 Maj 14:01


Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video




E premte | ? 20:45 | Syri TV






E premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV





Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.